



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.14/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Nenad Lazic dhe Zenel Leku, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - administrative të dënuarit: B. G. nga i ati B. dhe e ëma T., e gjinisë B., i lindur më datë ..., me vendbanim në fshatin S., Komuna K., duke vendosur sipas ankesës së të dënuarit, të paraqitur kundër vendimit të Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.93/24, të datës 06.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 25.04.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET si e pasafatshme ankesa e të dënuarit: B. G. nga i ati B. dhe e ëma T., e gjinisë B., i lindur më datë ., me vendbanim në fshatin S., Komuna K., e paraqitur kundër aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.93/24, të datës 06.03.2024.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.93/24, të datës 06.03.2024, është vendosur: I. Refuzohet kërkesa për lirim me kusht e të dënuarit B. G. nga i ati B. dhe e ëma T., e gjinisë B., i lindur më datë ., me vendbanim në fshatin S., Komuna K., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së K. . II. Kërkesa për lirim me kusht i refuzohet për periudhën kohore prej 5 muaj, e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Kundër aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht, i dënuari ka paraqitur ankesë, për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të aprovojë të bazuar ankesën e parashtruesit, dhe të pranohet kërkesa për lirim me kusht.

Paneli për Lirim me Kusht, me përgjigjen në ankesë ka kërkuar që të hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa e të dënuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 11 dhe 12 të Ligjit nr. 08/L-132, për Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, shqyrtoi ankesën e paraqitur nga i dënuari, aktvendimin e atakuar, si dhe shkresat e lëndës, dhe gjeti se:

Ankesa është e pasafatshme.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë PK.nr.41/23, të datës 11.07.2023, B. G. është shpall fajtor për shkak të veprave në bashkëkryerje vjedhje e rëndë e mbetur në tentativë nga neni 315 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 lidhur nenet 28 dhe 31 të KPKR-së, katër vepra penale bashkëkryerje vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe cenim i pa prekshmërisë së banesave dhe objekteve nga neni 197 par. 1 nënparafi 1.1 të KPRK-së, me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 1 vit e 6 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 700€.

Më datë 12.02.2024, i dënuari përmes Institucionit Korrektues ku është në mbajtje të dënimit me burg, ka parashtruar kërkesë për lirim me kusht me arsyetimin se gjatë mbajtjes së dënimit, me sjelljet e tij është arritur risocializimi i tij dhe janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për lirimin e tij me kusht.

Në seancën e mbajtur më datë 06.03.2024, Paneli pasi e shqyrtoi dosjen e të dënuarit, përkatësisht raportin përmbledhës të përpiluar nga Ekipi Profesionist i Institucionit Korrektues, Deklaratën - premtimin lidhur me mbikëqyrjen e të dënuarit pas lirimimit me kusht, ashtu siç është përcaktuar në nenin 116 të Ligjit Nr. 08/1-132 mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nenin 15 12 Rregullores Nr. 12/2023 për Punën e Panelit për Lirim me Kusht dhe pas vlerësimit të tërësishëm të çështjes gjeti se kërkesa për lirim me kusht është e pabazuar.

Kundër aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht, i dënuari ka paraqitur ankesë, andaj Gjykata Supreme e Kosovës, në këtë çështje juridike - kontestimore fillimisht vlerësoi lejueshmërinë e ankesës dhe konstatoi se në këtë rast ankesa është e palejueshëm, për arsye se:

Me neni 117, paragrafi 8, 11 dhe 12, të Ligjit nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, përcaktohet se: “ Pala e pakënaqur me vendimin e Panelit për Lirim me Kusht, ka të drejtë të ankohet ndaj vendimeve, drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të vendimi. 11. Gjykata Supreme, në një trup gjykues të përbërë nga tre (3) anëtarë, të zgjedhur nga Kryetari i Gjykatës Supreme, brenda tridhjetë (30) ditëve, shqyrton dhe vendos lidhur me ankesën. Në rast se konfliktit të interesit, atëherë zgjedhjen e anëtarëve e bën gjyqtari më i moshuar i Gjykatës Supreme. 12. Pas shqyrtimit të ankesës, Gjykata Supreme mund të konfirmojë vendimin e Panelit për lirim me kusht, ta ndryshojë atë, apo ta kthejë për rishqyrtim ”.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, Gjykata Supreme e Kosovës erdhi në përfundim se ankesa nuk lejohet kundër aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht, PLK.D.nr.93/24, të datës 06.03.2024, për arsye se dispozitat e cituara i referohen lejueshmërisë së ankesat e kushtëzuar përveç tjerash edhe me afatin për paraqitjen e ankesat i cili është 15 (ditorë), për të qenë e lejuar ankesa.

Në këtë rast nga shkresat e lëndës konstatohet se ankesa është paraqitur jashtë afatit ligjor. Nga e-mail, për dorëzimin e vendimit të dënuarit, përmes Institucionit Korrektues, i cili gjendet në shkresat e lëndës konstatohet se vendimi në Institucionin Korrektues është dorëzuar më datën Ankesën kundër aktvendimit të Panelit për Lirim me Kusht, i dënuari

e ka dorëzuar përmes postës më datë 11.04.2024, ndërsa e njëjta është dorëzuar në gjykatë më datë 15.04.2024, e që rrjedhimisht rezulton se ankesa është dorëzuar pas kalimit të afatit prej 15 ditësh, respektivisht 20 ditë pas kalimit të afatit për paraqitjen e ankesës. Në këtë rast afati për paraqitjen e ankesës fillon të llogaritet nga data 08.03.2024, e dita e fundit e afatit për paraqitjen e ankesat ka qenë data 22.03.2024, prandaj në këtë rast, ankesa është e palejuar, për shkak se është paraqitur pas afatit ligjorë 15 (ditorë).

Nga arsyet e paraqitura më lart, e në bazë të nenit 117 paragrafi 11, 12, të Ligjit nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

AA.nr.14/2024, më datë 25.04.2024.

Kryetari i kolegjit
Rrustem Thaqi